

Albulen Neziri
Adea Pula
Alban Muja
Ari Zharku
Art Haxhijakupi

Artan Hajrullahu
Behar Brahimi
Blerta Hoçia
Dardan Sopu
Driton Selmani

Eliza Hoxha,
Jetullah Sylejmani
Matilda Odobashi
Orhan Kurtolli
Remijon Pronja

Roland Masurica
Rozafa Imami
Valdrin Thaqi
Vigan Nimani



Muslim Mulliqi 2018

A janë Histori kujtimet tona?
Are our memories History?

EKSPOZITA NDËRKOMBËTARE ÇMIMI MUSLIM MULLIPI 2018 /
THE INTERNATIONAL EXHIBITION MUSLIM MULLIPI PRIZE 2018

A janë Histori kujtimet tona?
Are our memories History?

EDICIONI I 12 / 12TH EDITION
18.10. 2018 - 09.11. 2018

Koncepti kuratorial dhe përzgjedhja e artistëve /
Curatorial concept and selection of artists:
Iara Boubnova

Botues – Publisher:
Galeria Kombëtare e Kosovës
National Gallery of Kosovo

Teksti - Text:
Iara Boubnova, Ana Frangovska, Zeni Ballazhi

Fotografitë / Images:
Enver Bylykbashi

Përkthimi dhe lektura / Translation and proofreading:
Jehona Xhaferi

Dizajni / Design:
Trembelat

Shtypi / Print
VIPRINT

Viti / Year: 2018

Ekspozita dhe katalogu janë realizuar me mbështetje nga Ministria e
Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Raiffeisen Bank / The Exhibition And
Catalogue Are Supported by the Ministry of Culture, Youth and Sports and
Raiffeisen Bank:



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës/Vlada Kosova-Government of Kosovo

MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT



Sponsorë Medial / Media Sponsors:



Stafi i Galerisë Kombëtare të Kosovës- National Gallery of Kosovo staff:
Arta Agani, Drejtoreshë -Director; Zeni Ballazhi, Kurator-Curator;
Mehdi Maxhuni, Zyrtarë për financa -Finance officer; Lirije Buliqi,
Zyrtarë e lartë administrative -Senior administrative officer; Naim Spahiu,
Koordinator për ekspozita -Coordinator for exhibitions; Enver Bylykbashi,
Fotograf profesional -Professional photographer; Engjëll Berisha,
Koordinator për bashkëpunim ndërkombëtar dhe MR/ coordinator for
international cooperation and PR; Skender Xhukolli, Teknik për ekspozita
-Exhibition technician; Rrahman Bislami, Teknik për ekspozita/Mirëmbajtës
i objektit -Exhibition technician /Building caretaker; Xhevat Rrahimi,
Kujdestar i sallës ekspozuese -Exhibition hall attendant; Valdet Sylja &
Mentor Abdullahu, roje nate -security guards

Artistët pjesëmarrës / Participating artists:

Albulen Neziri, Adea Pula, Alban Muja, Ari Zharku, Art Haxhijakupi, Artan Hajrullahu, Behar Brahimi, Blerta Hoçia, Dardan Sopa, Driton Selmani, Eliza Hoxha, Jetullah Sylejmani, Matilda Odobashi, Orhan Kurtolli, Remijon Pronja, Roland Masurica, Rozafa Imami, Valdrin Thaqi, Vigan Nimani.

Juria / Jury:

Visar Mulliqi – Profesor i pikturës në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës/ Professor of painting at Faculty of Arts in Prishtina

Ana Frangovska – Kuratore në Galerinë Kombëtare të Maqedonisë/
Curator at the National Gallery of Macedonia

Valentina Bonizzi – Artiste visuelle / Visual artist

A janë Histori kujtimet tona?

Iara Boubnova

ALB

Paul Ricoeur në fillim të “Kujtesa, Historia, Harresa” (2000) shpjegon arsyen e shkrimit të librit: “Unë mbetem i brengosur nga spektakli shqetësues se shumë kujtesë lëshon pe këtu dhe shumë harresë lëshon pe atje, duke mos thënë asgjë për ndikimin e përkujtimit dhe abuzimit të kujtesës – dhe të harresës”. Në botën e sotme çdo gjë ndryshon tërë kohën. Duket se as e kaluara nuk është statike. Historia, kujtesa dhe përkujtimi janë objekt studimi i historianëve, antropologëve, sociologëve, filozofëve, historianëve të artit dhe letërsisë, po aq sa janë edhe shënjestër dhe material për manipulim politik.

Nuk ekziston vetëm një Histori dhe ne po jetojmë në një entropi të Historisë, por a mund ta ruajmë energjinë që mbledhet në “historitë” individuale dhe të vetme? Si është e mundur që historitë tonë të ndara individuale ta formojnë një lloj të historisë së shumëfishtë por njëkohësisht të përbashkët? A është e mundur që në disa vende mund të ketë thjesht shumë “Histori” që funksionojnë në të njëjtën kohë?

A mundet riarranzhimi i Historisë t’i “rregullojë” edhe tregimet individuale? A është e mundur që në të njëjtën kohë një ndryshim i Historisë t’i përmirësojë kujtimet individuale. A kemi kujtime të cilat nuk përshtaten me asnjë nga historitë e reja të shumëfishta përreth? A ka ndonjë shpresë që kujtimet tona të jenë pjesë e Historisë, apo të shumë historive, apo madje edhe të kujtesës kolektive?

Çfarë distance ka në mes të historisë zyrtare dhe kujtesës individuale? A ka mundësi që ndonjëherë ato të përputhen plotësisht dhe në çfarë kohe mund të ndodh kjo? A ka shpresë që ndonjëherë të ndodh kjo? A do të duhej të ndodh kjo? A e bëjnë Historinë synim prezencë e përkujtimeve dhe ajo se shumë kujtime janë në dispozicion?

Në të njëjtin libër Ricoeur flet për “dëshminë” si bazë për çdo lloj tregimi që ka të bëjë me të kaluarën. A është arti ende referencë për formimin jo vetëm të nocionit të dëshmisë por edhe për formimin e historisë së kohës tonë? Mementalisht imazhi vizual shumëfishohet në mënyrë teknike nga shumë sy, duar dhe pajisje... A është e mundur që arti të jetë “dëshmia” e vetme relevante që ka mbetur për tu përdorur në të ardhmen nga historianët?

At the beginning of his “Memory, History, Forgetting” (2000) Paul Ricoeur explained the reason for writing the book: “I remain concerned by the troublesome spectacle that too much memory gives here and too much forgetfulness gives there, to say nothing of the influence of the commemoration and the abuses of memory – and of forgetfulness.” In the world of today everything changes all the time. It turns out that the past is far from being static as well. History, memory and remembrance are as much the object of study for historians, anthropologists, sociologists, philosophers, historians of art and literature, as they are the target and material for political manipulation.

There is no one single History and we are living through the entropy of History, but could we preserve the energy stored in the singular, individual “histories”? How is it possible for our separate individual histories to form a kind of a multiple and yet common history? Is it possible that in some places there might be just too many “Histories” at work at the same time?

Might the rearrangement of History “fix” the individual stories too? Is it possible for the change of History to correct the individual memories at the same time? Do we have memories that do not fit into any of the new multiple histories around? Is there any hope that our memories are part of History, or of the many histories, or even of the collective memory?

What distances are there in between the official history and the individual memories? Might they ever overlap entirely and in what kind of times that might happen? Is there hope that it might happen ever at all? Should it happen at all? Do the presence of remembrances and the availability of a lot of memory make History an objective?

In the same Ricoeur book he is talking about the “testimony” as the basis for any kind of narrative concerning the past. Is art still referential for forming not only the notion of the testimonial but also for forming the history of our times? Currently the visual image is technically multiplied by the numerous eyes, hands and gadgets... Is it possible that art is the only relevant “testimony” left to be used by the historians of the future?

**Are our
memories
History?**

Iara Boubnova

ENG

KUJTESA vs HISTORIA: RELACIONI I KONFLIKTIT

**Drejt:
Are our
Memories
History?**

Ana Frangovska,
kuratore e lartë
në Galerinë
Kombëtare të
Maqedonisë

Një koncept interesant ofroi kuratorja e sivjetshme e edicionit të 12-të të ekspozitës tradicionale dhe prestigjioze garuese “Muslim Mulliqi” - lara Boubnova, kuratore e njohur botërore dhe drejtoreshë aktuale e Galerisë Kombëtare në Sofje - A janë kujtimet tona histori, e iniciuar nga libri i Paul Ricoeur, “Memory, History, Forgetting”. Ky diskurs është dialog tejet i zbatueshëm për një vend të ri siç është Kosova, dhe natyrisht i rëndësishëm për vendet e tjera të rajonit, ish republikat jugosllave, por edhe për disa fqinjë të ngushtë të Ballkanit. Historia e tyre e re dhe e larmishme përcakton një numër vërejtjesh të panjohura se si krijohet historia. Historia si një shkencë e së kaluarës mbështetet në fakte, prova, tregime, tekste, dëshmi, etj. ose të ashtuquajturit material historiografik i cili, pas shpikjes së tij, hetohet dhe sintetizohet në mënyrë që të provohet vërtetësia e tij. Është e njohur që këto tregime për të cilat nuk ka fakte më serioze, ndërkaq të reduktuara në narracione lokale të cilat kanë vlerë për njerëzit janë quajtur pasuri kulturore. Çfarë ndodh me kujtimet më të shpeshta që duhet të provohen dhe konfirmohen. A do të bëhen pjesë e kujtesës lokale apo kolektive, d.m.th. a do të jenë në gjendje të bëhen histori? A është kujtimi ose harresa një element kyç i pajtimit? Këto janë diskurse të brishta që janë ende të freskëta në rajonin tonë, i mbushur me shtete të reja të pavarura (shumica e të cilave janë krijuar me viktima të rëna dhe me besim të gërryer), për të cilën duhet të kalojë një distancë kohore më serioze, për t’u pjekur, për t’u provuar, për tu filtruar, nëse është e mundur, rrethanat dhe kushtet e kohëve të fundit ose të menjëhershme socio-politike.

Antropologu francez Mark Augze vuri në dukje:

“Rrëfimet personale që endin kujtimet tona - dhe na ndihmojnë të formojmë një ide se kush jemi - nuk varen vetëm nga puna konstruktive e kujtesës, por gjithashtu varen nga destruktiviteti i harresës. Kujtesa në njëfarë kuptimi varet nga harresa”.

Ja ku është kjo linjë e hollë, dhe ndërvlerësia e përjetshme dhe kundërshtimi i kujtesës apo harresës, që duhet të sigurojnë pajtim, harmoni, pranim kolektiv. Por a është e mundur kjo?

ALB

Nga ana tjetër, a është kujtesa kolektive një histori apo jo? Njëra është sintetike, tjetra analitike, e para është subjektive e dyta objektive, kujtesa kolektive është një lidhje e vazhdimësisë, ndërsa historia - jovazhdimësi, kujtimet janë të shumta dhe shumëfishohen, ndërsa historia është njëjës etj...

Në natyrën e çdo autoriteti dhe ideologjie është të imponohen llogaritë e përzgjedhura dhe të imponohet diskursi i vet shoqëror për ngjarjet e përzgjedhura të së kaluarës në mënyrë që të krijohet një version hegjemonist i së kaluarës. Mosveprimi, heshtja, injoranca, harresa, mungesa, mungesa e gjurmëve apo shenjave me gjuhët e tyre të veçanta të koduara përfaqësojnë pjesë përbërëse të këtyre politikave të kujtesës / harresës, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e transmetimit. Megjithatë, paraqitjet e kontestuarra të së kaluarës, të cilat ndonjëherë i neglizhojmë (sidomos në komunitetet që janë historikisht të prirura për homogenizim mendor dhe kulturor) mund të jenë të ndryshme dhe të shikuara nga kënde dhe perspektiva të ndryshme - por të gjitha janë të lidhura me strukturat e pushtetit, strategjitë e identitetit dhe politika institucionale e kujtesës / harresës.

Tregimet individuale vs. kujtimet kolektive dhe / ose historitë konsiderohen të rëndësishme në realizimin e pjesëmarrësve të ekspozitës garuese “Muslim Mulliqi”. Për ta bërë këtë, ata përdorin metoda të ndryshme të përafrimit dhe punës duke përdorur platformën e dokumentimit, transmetimit, intervistimit, arkivimit, redaktimit, citimit, ironizimit, interpretimit. Media diversiteti nga ana tjetër, ofron një gamë të gjerë të preokupimeve krijuese të artistëve dhe sugjeron se pavarësisht përdorimit të shpeshtë të formave digjitale të shprehjes vizuale, as mediat tradicionale nuk janë të huaja, as nuk kemi të drejtë të flasim për një lloj “fundi të artit” në kuptimin klasik të fjalës. Në tërësi një ekspozitë “e pakeluar” shkëlqyeshëm edhe në kuptimin kontekstual edhe në aranzhimin vizual.

Qasjet konceptuale përpunojnë diskurse të ndryshme, si: një konfrontim i drejtpërdrejtë i kujtesës kolektive me historitë personale (Art Haxhijakupi); dokumentimi i tregimit personal për të ndryshuar identitetin apo përkatësinë për të lehtësuar ekzistencën (Alban Muja), mbledhja e kujtimeve në

formën ready made të subjekteve dhe “ambalazhimit” e tyre në ambiente të mbyllura që ka perceptim të “paqartë” (Albulen Neziri); zgjimi i kujtimeve dhe veprimeve të së kaluarës me një rikapitulum të aranzhmaneve lëndore-hapësinore (Ari Zharku, Adea Pula); absurditete të historisë dhe fakteve, duke kultivuar konceptin e krahasimit në hapësirë dhe kohë, atje dhe këtu, njëkohësisht (Driton Selmani, Remijon Pronja). Pastaj inicimi i kujtimeve materiale të kujtesës kolektive dhe personale me ndihmën e pastërtisë metafizike - vizuale dhe hapësinore (Valdrin Thaçi); variantet e leximit të gabuar të historisë përmes lenteve të kujtimeve personale (Matilda Odobashi); dokumentimi nostalgjik i jetës së përditshme të njeriut të zakonshëm (Artan Hajrullahu); rishqyrtimi, duke cituar apo “fshirja” e pjesëve të matricave ideologjike socialiste të ikonografisë socio-realiste, monumente, histori të politikave mbizotëruese, fakte (Jetula Sulejmani, Vigan Nimani, Rozafa Imami); krijimi i “faloreve” të dedikuara për historinë dhe heroizmin e kohëve të fundit (Behar Brahimi); tranzicioni si një diskurs i kundërt i shpresës ose bllokadës (Dardan Sopa); kujtim nga fëmijëria (trashëguar imponuar, mësuar), e cila u bë pjesë përbërëse e perceptimit tonë të fundit të gjërave (Roland Masurica); trajtimi dhe aspekti i simbolizmit që ka dy kuptime aplikative duke konfrontuar elementin tradicional me (jo) emancipimin teknologjik të rajonit në fjalë (Eliza Hoxha), ndërsa si kontekstualizime të fundit të ekspozitës së paraqitur janë dy idioteka të kundërta, nga njëra anë fuqia manipulative sociale e masës, turmës (Blerta Hoxha) kundrejt qëndrueshmërisë së një dhe një personi të vetëm - nëna në rendin shoqëror të caktuar (Orhan Kurtolli).

Pas shqyrtimeve të nxituara të panoptikumeve konceptuale vizuale të artistëve të përzgjedhur, të pjesëmarrësve të këtij edicioni të ekspozitës garuese “Muslim Mulliqi”, pas shikimit paraprak në biografitë dhe arritjet e tyre deri më tani, mund të shihet se disa nga autorët janë përgjigjur në temë duke krijuar vepra që mund të përcaktohen si detyra të përpunuara në mënyrë të përshtatshme, sigurisht jo në kontekst negativ, dhe autorët që natyrisht me qasjen e tyre artistike të deritanishme dhe vijuese i përshtaten plotësisht temës së

dhënë „Are our memories History?“ të kuratores të projektit, lara Boubnova.

Nëse ne jemi dakord me përfundimin e Eco-së se “arti i harresës është i pamundur dhe i parealizueshëm”, efekti final i kësaj ngjarje është një ekspozitë e shkëlqyeshme e cila jo vetëm që ka një element “katartik” në vetvete, por sugjeron “pajtimin” me kujtesën personale, me tregimet personale si tregime personale të posaçme, të shikuara përmes prizmit të faktorëve krijues të dallueshëm në diskursin e dhënë shoqëror-social .

MEMORY vs HISTORY: CONFLICT RELATION

Are our Memories History?

Ana Frangovska,
curator at
National Gallery
of Macedonia

This year's curator of the 12th edition of the traditional and prestigious competitive exhibition "Muslim Mulliqi" – Iara Boubnova, a renowned curator and current director of National Gallery in Sofia – offered an interesting concept Are our memories history, inspired by Paul Ricoeur's book "Memory, History, Forgetting". This discourse is a very applicable dialogue for a new country like Kosovo, and obviously important for other countries of the region, ex-Yugoslav republics, but also for some other close neighbours in Balkans. Their new and diverse history determines a number of unknown remarks about the manner how history is created. History, as a science of the past is based on facts, proof, stories, texts, evidence, etc., or the so-called historiographic material, which, after its invention is investigated and synthesised in order to prove its veracity. It is well known that these stories for which there are no eligible facts, while reduced in local narrations, and very important for people are called cultural wealth. What happens with our most frequent memories that need to be proven and confirmed? Will they become part of local or collective memory, i.e. will they be able to become history? Is memory of forgetfulness a key element of reconciliation? These are fragile discourses still fresh in our region, filled with new independent states (most of which have been created through victims and eroded belief), for which a longer time distance needs to pass, in order for the recent or immediate socio-political circumstances and conditions to be established, proven and filtered.

French anthropologist, Mark Augze stated: "Personal stories that shape our memories – and help us establish an idea of who we are – are not dependent only on memory's constructive work, but also on forgetfulness' destructivity. In a way memory is dependent on forgetfulness itself".

Here lies a fine line, and eternal interdependence and contradiction of memory or forgetting that should provide for reconciliation, harmony, collective acceptance. But, is this possible?

On the other side, is collective memory history or not? One is synthetic, the other analytic, the first is subjective while the second is objective, collective memory is a link of

continuity, while history – non-continuity, memories are many and multiple, while history is singular, etc... **ENG**

It is in the nature of every authority and ideology to impose selected calculations and its social discourse for selected events of the past in a way to create a hegemonic version of the past. Inaction, silence, ignorance, forgetting, absence, lack of traces or signs of their specific coded languages represent composing parts of these memory / forgetting politics, which play an important part in the transmission process. However, contested representations of the past, which we neglect sometimes (especially in communities that are historically prone to mental and cultural hegemony) may be different and observed from different points of view and perspectives – but all of them are linked with power structures, identity strategies and institutional politics of memory / forgetfulness.

Individual stories vs. collective memories and / or histories are considered important by the participants of the competition exhibition “Muslim Mulliqi”. In order to do so, they use different methods of approximation and work by using the platform of documentation, transmission, interview, archiving, redacting, quoting, irony, and interpretation. On the other hand, media diversity offers a wide range of creative concerns of artists and suggests that despite the frequent use of digital forms of visual expression, traditional media are not extraneous, nor we have the right to talk about a kind of “end of art” in the classical sense. In general, an exhibition remarkably “packed” in contextual sense and visual arrangement.

Conceptual approaches produce different discourses, like: a direct confrontation of collective memory with personal histories (Art Haxhijakupi); documentation of a personal story of changing the identity or belonging to ease up the existence (Alban Muja); collection of memories in readymade subjects and their “packaging” in closed environments with “unclear” perception (Albulen Neziri); awakening the memories of past actions by recapturing the material-space arrangements (Ari Zharku, Adea Pula); history and fact absurdities, by cultivating the concept of comparison in time and space, here and

there, instantaneously (Driton Selmani, Remijon Pronja). And then initiation of material memories of collective and personal memory through the help of metaphysical – visual and space purity (Valdrin Thaçi); versions of erroneous reading of history through the lens of personal memories (Matilda Odobashi); nostalgic documentation of ordinary human daily life (Artan Hajrullahu); review, by quoting or “erasing” parts of social ideological matrix of socio-realist iconography, monuments, history of dominant politics, facts (Jetullah Sulejmani, Vigan Nimani, Rozafa Imami); creation of “temples” dedicated to recent history and heroisms (Behar Brahimi); transition as an opposite discourse of hope or blockage (Dardan Sopa); childhood memory (inherited, imposed, learned), which became an integral part of our perception of end of things (Roland Masurica). Treatment of the aspect of symbolisation, which has two applicative meanings by confronting traditional element with technological (non) emancipation of the abovementioned region (Eliza Hoxha), while the last contextualisation of the exhibition are two opposite idiotechs, on one side social manipulative power of the mass (Blerta Hoxha) opposite the durability of one and only one person – mother in the specific social class (Orhan Kurtolli).

Following the hasty review of conceptual visual panopticons of selected artists, participants in this edition of competition exhibition “Muslim Mulliqi”, and after initial review of their biographies and achievements, it may be observed that some of the authors have responded to the topic by creating art pieces that may be determined as appropriate works, obviously not in negative sense, and authors who by their approach up to now and in the future are conform the given topic “Are our memories History?” of the project curator, Iara Boubnova.

If we agree with Eco’s conclusion that “art of forgetting is impossible and unachievable”, the final effect of this event is a remarkable exhibition, which not only has a “cataract” element in itself but also suggests “reconciliation” with personal memory, with personal stories as specific personal stories, seen through the lenses of creative factors distinguished in the given social discourse.

**Ekspozita
Ndërkombëtare
Çmimi “Muslim
Mulliqi”**

Zeni Ballazhi,
kurator në GKK

Në vitin 2003, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Galeria e Arteve e Kosovës miratuan një rregullore për të realizuar një dëshirë shumë të madhe institucionale. Për herë të parë u themelua shpërblimi më i lartë vjetor në artet pamore me emrin e doajenit e piktorit të parë akademik Muslim Mulliqi, i cili me krijimtarinë e tij pamore la gjurmë të pashlyeshme në artin pamor shqiptar.

Muslim Mulliqi u lind në vitin 1934 në Gjakovë. Akademinë e Arteve Figurative e kreu në Beograd te profesor Zora Petroviq. Studimet pasuniversitare i kreu te i njëjti profesor në vitin 1961. Ka qenë anëtar i SHAFK që nga themelimi. Ai ishte njëri prej themeluesve dhe Dekani i parë i Akademisë së Arteve në Prishtinë, ndërsa anëtar i Akademisë së Shkençave dhe Arteve të Kosovës që nga viti 1980. Ka pasur shumë ekspozita personale dhe ka marrë pjesë në shumë ekspozita kolektive në vend dhe jashtë vendit, si dhe ka fituar shpërblime kombëtare dhe ndërkombëtare. Veprat e tij gjenden te shumë koleksionarë, galeri e muze. Vdiq në vitin 1998.

Në dhjetor të vitit 2003 u hap dhe u promovua Çmimi Muslim Mulliqi si ekspozita e parë tradicionale ndërkombëtare. Kjo ekspozitë pati një jehonë të madhe dhe vërtetoi që artistët tanë reflektuan eksperiencën e tyre pamore në nivel ndërkombëtar dhe vulosën dëshirën e madhe të Galerisë për të pasur një ekspozitë të përmasave ndërkombëtare, e cila rrugëtoi suksesshëm që nga viti 2003 dhe vazhdon të jetë ngjarja më e madhe në artet pamore në Kosovë. Që nga viti 2012 çmimi i konkursit Muslim Mulliqi është aktivitet ndërkombëtar që organizohet çdo dy vjet si bienale ndërkombëtare.

Kjo bienale, tani më tradicionale, promovon shumë artistë dhe kuratorë vendor e ndërkombëtarë, si dhe komisione vendore dhe ndërkombëtare për ndarjen e çmimit “Muslim Mulliqi”, të përbërë nga artistë profesionistë të fushave të ndryshme.

Ekspozita Ndërkombëtare Çmimi “Muslim Mulliqi” 2018, këtë edicion promovoi artistët të cilët iu përgjigjën pyetjes: A janë histori kujtimet tona?, nga kuratorja lara Boubnova. “A është e mundur që arti të jetë “dëshmia” e vetme relevante që ka mbetur për tu përdorur nga historianët e të ardhmes?”.

ALB

Sipas përzgjedhjes së kuratores të këtij edicioni, lara Boubnova, artistët pjesëmarrës janë: Albulen Neziri, Adea Pula, Alban Muja, Ari Zharku, Art Haxhijakupi, Artan Hajrullahu, Behar Brahimi, Blerta Hoçia, Dardan Sopa, Driton Selmani, Eliza Hoxha, Jetullah Sylejmani, Matilda Odobashi, Orhan Kurtolli, Remijon Pronja, Roland Masurica, Rozafa Imami, Valdrin Thaqi dhe Vigan Nimani.

Komisioni seleksionues i përbërë nga Visar Mulliqi, Ana Frangovska dhe Valentina Bonizzi ia ndau çmimin për veprën më të mirë të këtij edicioni artistëve Artan Hajrullahu dhe Valdrin Thaqi. Ky çmim do t'i inkurajojë artistët dhe do tu ofrojë mundësinë që të jenë në lartësinë e duhur.

Artan Hajrullahu ekspozoi me mjaft mjeshtëri teknikat e tij të rafinuara. Ai di mjaft mirë t'i zotërojë mjetet e tij të shprehjes në vizatime, laps në pako, letër dhe karton, pikturë, vaj në pëlhurë dhe dërrasë, të punuara sipas konceptit kuratorial. “Puna e tij artistike është e preokupuar me tema të jetës së përditshme dhe nostalgjisë. Vizatimet e tij, përshkruajnë skena të përditshme dhe kujtime të fëmijërisë së artistit, ku marrëdhëniet midis qenieve njerëzore dhe objekteve shtëpiake tregojnë histori poetike”.

Te veprat e tij, ideja themelore është moduli, uniteti i masës, standardi, paraqitja konceptuale dhe pafundësisht e vogël e një infiniti gjeometrik. Një infinit i përbërë nga megapoli, shtrirja urbane që e gjen vlerën e vet tek sasia.

“Rikujtimi i Kujtimeve”, audio-instalacion ku sipas Valdrin Thaqi: “Kujtesa është një gjë shumë e brishtë. Ajo është konstruktive, ajo është rikonstruktive. Mund të hysh e të dalësh, mund ta ndryshosh. Të gjithë ne vuajmë nga kujtesa e shtypur, dhe kjo nuk na sfidon ne sepse ne brengosemi me ato kujtime vetëm kur fillojmë t'i rikujtojmë kujtimet që na e sfidojnë realitetin momental”.

Të kërkosh një përkufizim oriental të hapësirës nga pikëpamja pamore, në të cilën e plotë dhe boshllëku, drita natyrale dhe artificiale gjejnë vazhdimësinë e njëra-tjetrës.

Ekziston një çast reduktues në të cilin përmblihet një sasi fizike e hapësirës, duke e pastruar atë nga të gjitha aksidentet ndijmore, të të prekurit, të të dëgjuarit, të të nuhaturit me të cilat zakonisht jemi në kontakt, duke e çuar atë

në kushtëzimin fenomenologjik të një mbështjelljeje e cila e përforcon, thjesht për shkak të izolimit të vetvetes, perceptimin psiko-sensual të spektatorit.

“A janë histori kujtimet tona?” frymëzon dhe lajmëron pjesëmarrjen e artistëve në hapësirat ekspozuese të Galerisë. Vizioni institucional si një “vizion pa vizion të vetëpërcaktuar” ka tendencën e krijimit të hapësirave të plota, në mbështetjen e çdo projekti, artisti apo grupi artistësh, të cilët me fantazinë dhe inteligjencën e tyre pamore, ndjeshmërinë dhe emocionin provokues, shfaqin një art bashkëkohor të ngjizur me dilemat e kalimit të madh drejt Mijëvjeçarit të Ri.

Cilësia më e qëndrueshme në artin figurativ të ekspozuar nga ky grupim artistik është pa dyshim tendenca e pranueshme e zgjerimit të dimensioneve të kësaj fushe.

Kjo lind nga nevoja për ta pyetur veten, për të arritur në përkufizimin e sistemit të artit, për tu vendosur një analizë e shprehjes gjuhësore artistike që përdoret metoda dialektike.

Raporti realitet - krijim ka vlera të ndryshme për vepra të ndryshme.

Çmimi “Muslim Mulliqi” i është futur një rrugë të gjatë e cila premtë të reja të pafundme.

In 2003, Ministry of Culture, Youth and Sports and National Gallery of Kosovo approved a regulation for implementing a longstanding institutional desire. For the first time it was enabled to establish the first highest annual award for visual arts named after the first dean and academic painter Muslim Mulliqi, who left an indelible legacy in Albanian visual arts with his visual opus.

Muslim Mulliqi was born in 1934 in Gjakova. He graduated from the Academy of Figurative Arts in Belgrade, with Professor Zora Petrovic. He finished his tertiary studies with the same professor in 1961. Since the establishment of AFAK he was a member of it. Muslim Mulliqi was one of the founders and the first Dean of Academy of Arts in Prishtina, while he was member of Academy of Science and Arts of Kosovo since 1980. He had a lot of personal exhibitions and participated in many collective exhibitions in country and abroad, as well as received many national and international awards. His works are part of many galleries, museums and personal collections. He died in 1998.

In December 2003, the Award Muslim Mulliqi was opened and promoted as the first traditional international exhibition. This exhibition had a huge echo and proved that our artists reflected their visual experiences in international level and sealed the big desire of the Gallery to have an exhibition of international dimensions, which had its successful journey since 2003 and continues to be the biggest event in visual arts in Kosovo. Since 2012, the Muslim Mulliqi award competition is an international activity which is organized every second year as an international biennale.

This biennial, which has become traditional for several years now, promotes many local and international artists and curators, as well as local and international commissions for awarding the “Muslim Mulliqi” award, comprised of professional artists in different fields.

In this edition, the International Exhibition “Muslim Mulliqi” Award 2018 promoted artist who responded to the question: Are our memories history?, from the curator Iara Boubnova. “Is it possible that art is the only relevant “testimony” left to be used by the historians of the future?”

International Exhibition “Muslim Mulliqi” Award

Zeni Ballazhi,
curator in NGK

ENG

According to the curator of this edition Iara Boubnova, the participating artists are: Albulen Neziri, Adea Pula, Alban Muja, Ari Zharku, Art Haxhijakupi, Artan Hajrullahu, Behar Brahimi, Blerta Hoçia, Dardan Sopa, Driton Selmani, Eliza Hoxha, Jetullah Sylejmani, Matilda Odo bashi, Orhan Kurtolli, Remijon Pronja, Roland Masurica, Rozafa Imami, Valdrin Thaqi and Vigan Nimani.

The Selecting commission comprised of Visar Mulliqi, Ana Frangovska and Valentina Bonizzi, awarded the prize for the best art work of this edition to artists Artan Hajrullahu and Valdrin Thaqi. This award will encourage the artists and give them an opportunity to develop.

Artan Hajrullahu exhibited his refined techniques with quite mastery. He has knowledge in mastering his means of expression in drawings, pencil in package, paper and cardboard, paintings, oil in canvas and wood, worked according to the curatorial concept. "His artistic work is preoccupied with nostalgia and daily life topics. His drawings describe daily scenes and childhood memories of the artist, where relations among humans and home objects show poetic histories".

The main idea in his works is module, mass unity, standard, conceptual and infinitely small presentation and of a geometric infinity. Infinity comprised of megalopolis, urban distribution that finds its value in quantity.

"Recalling Memories", an audio-installation, where according to Valdrin Thaqi: "Memory is a very fragile thing. It is constructive, it is re-constructive. You may enter and leave, you may change it. We all suffer from oppressed memories, and this does not challenge us because we worry about those memories only when we start to recollect the memories which challenge our current reality".

Searching for an oriental definition of space from visual aspect, where the full and void, natural and artificial light find the continuity of one-another.

There is a reducing moment where he collects a physical quantity of space, by clearing it from all sensors, touch, hearing, smelling accidents with which we are usually in contact, by sending it in phenomenological conditioning of a covering which strengthens the psycho-sensual perception of

the spectator, simply due to isolation of oneself.

"Are our memories history?" inspires and announces the participation of artists in exhibiting space of Gallery. Institutional vision as a "vision without self-determining vision" has a tendency of creating full spaces, in support of each project, artist or group of artists, who through their visual fantasy and intelligence, sensitivity and provoking emotion, express a contemporary art gestated with dilemmas of the big transition towards the New Millennial.

The most sustainable quality in figurative art exposed by this group of artists is inevitably the acceptable tendency of expanding the dimensions of this field.

This comes from the need to ask ourselves, to reach the definition of art system, to establish an analysis of artistic language expression used for dialectical method.

The reality - creation relation has different values for different art pieces.

"Muslim Mulliqi" award has entered a long path which promises infinite novelties.

**Çmimi më i
lartë për arte
pamore i caktuar
nga Ministria e
Kulturës, Rinisë
dhe Sportit gjatë
viteve 2003-2018**

Ekspozita Ndërkombëtare “Çmimi M.Mulliqi” 2003

International exhibition “M.Mulliqi Prize” 2003

Kurator/Curator: Dr. Nadja Zgonik

As.Kurator/Ass.curator: Gani Llaloshi

Juria/Jury: Gjelo Gjokaj, Nadja Zgonik, Gëzim Qendro

Fituesit/Winners: Jakup Ferri dhe Lulzim Zeqiri

Ekspozita Ndërkombëtare “Çmimi M.Mulliqi” 2004

International exhibition “M.Mulliqi Prize” 2004

Kurator/Curator: Gëzim Qendro

As.Kurator/Ass.Curator: Vesa Sahatçiu

Juria/Jury: Eqrem Basha, Joa Ljunberg, Anjali Sen

Fituesit/Winners: Dren Maliqi dhe Mario Rizzi

Ekspozita Ndërkombëtare “Çmimi M.Mulliqi” 2005

International exhibition “M.Mulliqi Prize” 2005

Kurator/Curator: Mehmet Behluli

As.Kurator/Ass.Curator: Dren Maliqi

Juria/Jury: Nikola Dietrich, Sergio Boynuk, Gëzim Qendro

Fituesit/Winners: Alban Hajdinaj dhe Hysein Alptekin

Ekspozita Ndërkombëtare “Çmimi M.Mulliqi” 2006

International exhibition “M.Mulliqi Prize” 2006

Kurator/Curator: Mustafa Ferizi

Juria/Jury: Suzana Varvarica-Kuka, Agim Salihu,

Basri Çapriqi

Fituesit/Winners: Nebih Muriqi dhe Ismet Jonuzi

Ekspozita Ndërkombëtare “Çmimi M.Mulliqi” 2007

International exhibition “M.Mulliqi Prize” 2007

Kurator/Curator: Suzan Varvarica-Kuka

Juria/Jury: Nadja Zgonik, Gjelo Gjokaj, Ali Podrimja

Fituesit/Winners: Lumturi Blloshmi dhe Bekim Glloku

Ekspozita Ndërkombëtare “Çmimi M.Mulliqi” 2008

International exhibition “M.Mulliqi Prize” 2008

Kurator/Curator: FILOART, Zeni Ballazhi

Fituesit/Winners: “Jea Pas” group

Ekspozita Ndërkombëtare “Çmimi M.Mulliçi” 2009

International exhibition “M.Mulliçi Prize” 2009

Kurator/Editor: Michele Robecchi, Gazmend Ejupi**Juria/Jury:** Albert Heta, Zake Prelvukaj**Fituesit/Winner:** Antigona Selmani, Loreta Ukshini,
Malësor Bejta**Ekspozita Ndërkombëtare “Çmimi M.Mulliçi” 2010**

International exhibition “M.Mulliçi Prize” 2010

Kurator/Editor: Valbona Rexhepi, Fitore Isufi-Koja**Juria/Jury:** Penesta Dika, Gëzim Panariti, Musa Ramadani**Fituesi/Winner:** Abedin Azizi**Ekspozita Ndërkombëtare “Çmimi M.Mulliçi” 2012**

International exhibition “M.Mulliçi Prize” 2012

Kurator/Editor: Charles Esche, Galit Eliat**Juria/Jury:** Zdenka Badovinac, Vasif Kortun, Sokol Beqiri**Fituesit/Winner:** Fatos Kabashi**Ekspozita Ndërkombëtare “Çmimi M.Mulliçi” 2014**

International exhibition “M.Mulliçi Prize” 2014

Kurator/Editor: Corinne Diserens**Juria/Jury:** Laurence Rassel, Friedrich Meschede,
Visar Mulliçi**Fituesit/Winner:** Flaka Haliti**Ekspozita Ndërkombëtare “Çmimi M.Mulliçi” 2016**

International exhibition “M.Mulliçi Prize” 2016

Kurator/Editor: Artan Shabani**Juria/Jury:** Boris Brollo, Eqrem Basha, Krenar Zejno**Fituesit/Winner:** Fani Zguro**Ekspozita Ndërkombëtare “Çmimi M.Mulliçi” 2018**

International exhibition “M.Mulliçi Prize” 2018

Kurator/Editor: Iara Boubnova**Juria/Jury:** Visar Mulliçi, Ana Frangovska,**Valentina Bonizzi****Fituesit/Winner:** Artan Hajrullahu, Valdrin Thaqi

Albulen Neziri

Pa titull / Untitled, 2018

Instalacion; libra shkollor, romane, dorëshkrime, korniza druri, qelq (ornament deltagriz), dhe ngjitës dy-komponentësh.
Installation; textbooks, novels, writings, wooden frames, glass (ornament deltagriz), and two-component glue.
120 x 90 x 30 cm

ALB

I përzgjedha disa gjësende si “koleksion kujtimesh” që i takojnë të kaluarës sime që nga viti 1995 e deri në vitin 2004. Libra shkollor, lektyra, romane, abetaren, fletore të ndryshme, dorëshkrime, etj. Vendosa një qelq të turbullt mbi to i cili e lëshon dritën, por nga jashtë nuk mund të shihen qartë gjërat brenda. Në këtë rast qelqi i vendosur përsipër krijon një metaforë dhe luan rolin e perdes mes asaj që na kujtohet apo nuk na kujtohet. Pas një kohe të caktuar përjetimet dhe përvojat e mëhershme fillojnë të bëhen të turbullta, nganjëherë të paqarta apo edhe të harrohen.

I selected several items as a “collection of memories”, which belong to my past from 1995 until 2004. Textbooks, readings, novels, alphabet book, different notebooks, writings, etc. I placed a blurred glass over them, which lets the light in, but from the outside one can’t see clearly the items inside. In this case the glass on top creates a metaphor and plays the role of a curtain between the things we remember or don’t remember. After a while, previous feelings and experiences start to become blurred, sometimes unclear or even forgotten.

ENG



Albuleen Neziri







Adea Pula

Simfonia / The symphony

Instalacion: karrigë luhatëse, maqinë e qepjes/

Installation: rocking chair, sewing machine

ALB

Të jetosh në mes të dy vendeve, që së bashku përjetuan luftën nga armiku i njëjtë, është barrierë e rëndë. Çdo gjë në Ballkan pothuajse është e njëjtë, Serbia pika kyçe që ndan dy shtete, Kosovën dhe Bosnjën, të cilat përballen përafërsisht me problemet e njëjta. Rreth viteve 1992-1995 u zhvillua lufta në Bosnje, të cilën unë nuk e mbaj mend, pasi që jam lindur në vitin 1993. Jam rritur me tregimin, që gjyshja ime, e cila vinte nga vendi i vockël i quajtur Tesanj, nga Bosnja e Hercegovina, gjatë atyre viteve nuk kishte asnjë lajm nga familja e tyre. Nuk dinte a janë të gjallë, ku gjinden, a janë duke luftuar apo kanë shkuar në ndonjë shtet tjetër. Nëna ime, u mundua që me anë të njohjeve që kishte të siguronte një telefon, i cili përdorej nga njerëz të caktuar për të komunikuar me të tjerët në Bosnje. Kishte shpresë të vogël pothuajse të shuar që do të mundte të binte në kontakt me ta. Mirëpo pas disa kohësh mori përgjigjen që të gjithë ishin mirë, po mundoheshin t'i përballonin situatën së rëndë dhe të luftonin për mbrojtjen e vendit të tyre. Në mendjen time kam fjalët e tyre që kohë pas kohe përsëriten, të cilat janë aq të mbushura me emocion, sikurse më duket që e kam parë atë ndodhi në realitet. Jam rrit në një frymë më liberale sesa të tjerët në Kosovë, mirëpo në të njëjtën kohë edhe nënçmuese që një e katërta ime i takon një vendi që sipas të tjerëve janë “serb”, janë armiq të tanë. Gjyshja ime rreth viteve të 60ta, la vendin e saj që të vinte të punonte këtu, pasi që firma ku ajo punonte në Jugosllavi,

kishte mungesë të punëtorëve në sektorin e saj. U nënçmua në shumë mënyra, me fjalët më ofenduese, me vepra të pahijshme, mirëpo mirësjellja e saj ishte sulmi për këto veprime. Krijonte art, qepte gjëra që ishin moderne në vendet evropiane, që në Kosovë ishte një lloj i veshjes që konsiderohej jo aq i rehatshëm. Arriti që me diturinë, punën, karakterin, përballjen e shumë dukurive që mbizotëronin vendin tonë të krijojë artin e saj. Arriti që me anë të punës por edhe dashurisë që kishte për këtë vend, të shpërndajë ndjenjat e saj ndër njerëz. Ulqini është bërë pikë takimi ynë me pjesën tjetër të familjes që gjendet në Sarajevë, pasi që të dy palët nuk kemi të drejtë të hyjmë në shtetet përkatëse. Pra kufijtë, një shtet, Serbia, janë faktorët që një familje duhet të jetë e ndarë në dy pjesë. Nga gjithë gjërat që mbaj mend, më kryesorja është një makinë e qepjes, e punuar nga druri dhe metali, model antik dhe një karrige luhatëse e cila në mendjen time ende lëviz aq lehtë sikurse dikush të lëkundej në të. Është ai kujtim që për mua simbolizon një GRUA, që me anë të artit të saj, lidhi dy vende, bëri diçka që ne sot po mundohemi ta bëjmë me anë të artit, mirëpo ajo u kujdes që tërë jetën e saj t’ia dedikojë krijimit të diçkaje të bukur. Propozimi im është që me anë të një instalacioni të një makine qepjeje dhe një karrige luhatëse, që kanë udhëtuar nëpër kohë, të shpreh lidhshmërinë në mes të dy vendeve. Të shpreh që arti njëmend di të bashkojë njerëz, di të thyjë barriera, di të krijojë raporte shoqërore ndër vite.

ALB

Living in between two places, that experienced war from the same foe, is severe. Everything in the Balkan is almost the same, Serbia, the central plank that separates two countries, Kosovo and Bosnia, both dealing with the same problems. Between 1992-1995 there was a war happening in Bosnia, which I don't remember because I was born in 1993. I grew up hearing the story that my grandmother, who came from a really small place called Tesanj, from Bosnia and Herzegovina, didn't hear from her family during all those years. She didn't even know if they were alive, where they were staying, if they were fighting for their lives or leaving the country. My mother had some connections, so she tried to ensure a telephone that they would use to communicate with particular people in Bosnia. She was hoping that she will somehow contact them. But, after some days they told her that they were all okay, they were trying to face the difficult situation and fight for their country. In my mind I can still hear their words, I can still feel the emotion, It's like I've been there with them all the time and I saw everything. I was raised in a different way than the others in Kosovo, more liberal I would say, but at the same time I was always punished for the fact that part of my family is from a place that makes them known as "Serbians", our enemies. Around 60s, my grandmother left her country so she could come and work here because the company where she was working in Yugoslavia, had a lack of workers in her section. She was put down in many ways with offensive words and improper behavior. But her goodwill was the best response to those people. She created art by sketching modern clothes that in that time were only modern in Europe. Here in Kosovo those kind of clothes weren't considered to be that comfortable. Apart from all the difficulties, she managed to

create her own art with her hard work, passion and skills. By the time her work was done and was accepted by people in a good way, she was proud to have spread her feelings among people. Besides everything she was a role model to all the other females by sending them the message that you can achieve anything if only you love and work hard for it. Ulcinj has become our meeting place with the other part of my family from Sarajevo since both of us are not allowed to visit each other's countries. So, borders, a country, Serbia, are the main reasons that a family remains separate. From everything I remember, the most important one is that sewing machine built from wood and metal, antic model and a swinging chair which in my mind still moves slowly like someone's still sitting on it. That's the memory that for me symbolizes a WOMAN that through her art made two places become together as one, something that we're still trying to do today, but she carefully dedicated her whole life to something so beautiful. My proposal is that a sewing machine and a swinging chair that have traveled in time, they can show the connection between two places. Show everyone that art can connect people with each other, destroy barriers and create social reports through years. A dark room or pavilion, a single light that has the main focus of the sewing machine and the swinging chair, which moves slower as if someone was sitting in it, creates a visual and emotional feeling that someone still exists there. With this, I want to show a link and a call for compliance between countries, and to show that today we are trying to make relations between society through art, but without us knowing it has started to create already. Subconscious, memories and nostalgia are things that keep the society united in different ways.





Alban Muja

Forca, 2018

Video, 11 min

ALB

Vitet 1990-ta ishin të vështira për shqiptarët. Ata jetonin në dy shtete të Ballkanit, në Shqipëri, e cila sapo kishte dalë nga diktatura e “hekurt”, dhe në ish-Jugosllavi, e cila ishte e pushtuar nga luftërat. Shqiptarët në të dy anët e kufirit ishin të izoluar për dekada të tëra dhe nuk kishin kontakt me njëri-tjetrin, madje edhe anëtarët e të njëjtave familje ishin të ndara në të dy anët e kufirit. Për herë të parë shqiptarët e të njëjtit gjak filluan të takohen në mbeturinat e anijeve, duke ikur në mënyrë ilegale drejt shteteve perëndimore për të gjetur paqe dhe një jetë më të mirë. I njëjti fat e gjeti edhe ‘Forcën’ dhe familjen e saj, të cilët ikën në mënyrë ilegale në Gjermani për të kërkuar azil. Pas shumë peripecish gjatë rrugës, ‘Forca’ dhe prindërit e saj arritën në Gjermani, por fatkeqësisht kërkesa e tyre për azil u refuzua. Situata e njëjtë nuk ndodhi edhe për ‘Forcën’ e vërtetë dhe familjen e saj nga Kosova. Ata e fituan azilin për shkak të luftërave në ish Jugosllavi. Tre anëtarë të një familje shqiptare nga Shkodra në Shqipëri dhe tre anëtarë të një familjeje nga Gjakova në Kosovë shoqëroheshin për një kohë. Pasi që familjes nga Shkodra iu refuzua azili, ata i morën dokumentet kosovare dhe ikën për në Itali. Në Itali ata e fituan azilin me identitetin e familjes kosovare, duke jetuar me pothuaj se 20 njerëz me identitete të rreme. Kështu që, të dy familjet jetojnë dhe i pranuan dokumentet nga dy shtete të ndryshme të BE-së, me një palë dokumente. Një fenomen i tillë, ku shqiptarët nga Shqipëria paraqiten për të kërkuar azil si kosovarë ka ndodhur pothuaj se në të gjitha shtetet perëndimore. Madje edhe sot, mijëra familje shqiptare jetojnë në perëndim si familje kosovare, ndërsa familja e ‘Forcës’ është vetëm njëra nga ato.

The 1990s were very difficult for Albanians. They lived in two Balkan states, in Albania, which just emerged from the “iron” dictatorship, and in the former Yugoslavia, which was occupied by wars. For decades, Albanians on both sides of the border were isolated and had no contact with each other and even members of the same families were separated on both sides of the border. For the first time Albanians of same blood, began to meet in the wreckage, fleeing illegally in Western countries to find peace and a better life. This same luck followed also ‘Forca’ and her family, who illegally flew to Germany to seek asylum. After many vicissitudes along the way, ‘Forca’ with her parents arrived in Germany, but unfortunately, their asylum was rejected. This situation didn’t happen the same way for the real “Forca” and her family from Kosovo. They received asylum because of the wars in former Yugoslavia. Three members of an Albanian family from Shkodra in Albania and three members of a family from Gjakova in Kosovo were socializing for a period of time. After the family from Shkodra was refused the asylum, they took the Kosovar documents and fled to Italy. In Italy, they got asylum with the identity of the Kosovar family, living with almost 20 people with fake identities. So, the two families live and receive the documents from two different EU countries, with one pair of documents. Such a phenomenon, where Albanians from Albania were introduced to seek asylum as Kosovars, has occurred almost in all the western countries. Even nowadays, thousands of Albanian families live in the West as Kosovar families, whereas “Forca’s” family is just one of them.



only three months older
Forca, Vjollca

Alban Muja







Ari Zharku

Sinti Akumulues / Accumulating Synth, 2018

Termo (Stufa Akumuluese) / Termo (Accumulating heater),
Piano Elektronike (Sinti) / Electronic Piano (Synth)
Stoli / Bench

ALB

Supozoj, por megjithatë mendoj se e kam me të drejtë, kur them se çdokush së paku një herë ka pas dëshirë/dëshiron të udhëtojë në kohë.

Atëherë, pse mos ta bëjmë të mundur.

Pasi që nuk jam shkencëtar atëherë edhe nuk mund ta ndërtoj makinën e kohës e cila do ta dërgonte trupin tuaj fizik në të kaluarën. Por, ajo që mund të bëj është ta krijoj një vepër arti e cila mund të ketë kuptim për disa njerëz, dhe nëse ndërveproni me të, atëherë ndoshta mund ta ri-përjetoni të kaluarën tuaj nga ditët e fëmijërisë apo të rinisë. Kjo “makinë kohe” mund të jetë pak e prishur pasi që kompozicioni i saj është i bazuar në personale, kështu që nuk do të munden të gjithë ta përdorin për tu kthyer në kohë, dhe nuk do të shkojnë të gjithë në të njëjtin udhëtim për në destinacionin e tyre subjektiv.

Kështu që për ata që munden, kënaquni në udhëtimin tuaj në shtegun e memories.

I'm just guessing, but I still think that I'm right, when I say that everyone at least once wanted/ wants to time travel.

ENG

So why not make it possible.

Since I'm no scientist, I can't build a time machine that will take your physical body to the past. But what I can do is create a work of art which may be relatable for some people, and if you interact with it maybe you can re-experience your past from your childhood or youth days. This "time machine" can be a little bit broken since its composition is personal based, so not everyone will be able to use it to go back in time, and not everyone will go through the same journey to their subjective destination.

So for those who can, please enjoy your trip to memory lane.







Art Haxhijakupi

**Segmentet e Recollection /
Segments of Recollection, 2017**

Video

ALB

Gjatë viteve 90-të, përderisa në Kosovë tensionet rriteshin dhe më pas shpërthyen në luftë të hapur, fëmijët e izoluar shqiptarë ndërtuan një botë private të botëkuptimit dhe intimitetit nga vorbulla e tingujve dhe imazheve që hynin në shtëpitë e tyre. Artisti rikrijon kujtimet e tij të fëmijërisë të këtyre viteve në një përpjekje për ta vendosur këtë periudhë në qendër të kujtesës kolektive. Në kryqëzimin mes dy realiteteve të ndryshme, tregimi i kësaj vepre është i ndërtuar në mënyrë spontane. Struktura e tij lë shumë hapësira në të cilat ngjarjet dhe përvojat bëhen më të rëndësishme. Recollection përqendron vëmendjen në shkyçjen e detyruar të vendosur nga regjimi serb mes publikes dhe private për të treguar se si kjo e fundit u bë një institucion alternativ por i vetmi për shqiptarët e Kosovës. Recollection u publikua për herë të parë në vitin 2017 si dokumentar eksperimental dhe u paraqit në një numër festivalesh në disa vende të botës.

During the 90s, when tensions in Kosovo were increasing, which later broke into an open war, isolated Albanian children built a private world of understanding and intimacy from vortexes of sounds and images entering their houses. The artist recreates his childhood memories from this period of time trying to place this period in the centre of collective memory. In the crossroad between two different realities, the narrative of this art piece is built spontaneously. Its structure leaves space for the events and experiences to become more important. Recollection brings attention to the forced division between the public and private brought by the Serbian regime, to show how the latter became an alternative institution, and the only one for Albanians of Kosovo. Recollection was published for the first time in 2017 as an experimental documentary and was presented in a number of festivals in several countries.

ENG









Artan Hajrullahu

Vizatim, Laps në pako letër dhe karton, 2017-2018

Pikturë, Vaj në pëlhurë dhe dërrasë, 2017-2018 /

Drawing, Pencil in package paper and cardboard, 2017-2018

Painting, Oil on canvas and wood, 2017-2018

ALB

Puna e tij artistike është e preokupuar me tema të jetës së përditshme dhe nostalgjisë. Vizatimet e tij, përshkruajnë skena të përditshme dhe kujtime të fëmijërisë së artistit, ku marrëdhëniet midis qenieve njerëzore dhe objekteve shtëpiake tregojnë histori poetike.

Fitues / Winner of Muslim Mulliqi 2018

His artwork is preoccupied with daily life topics and nostalgia. His drawings depict every day scenes and childhood memories of the artist, where relationships between humans and household items present poetical history.

ENG









Behar Brahimi

Dhoma e të pagjeturit / The room of the unfound

Instalacion / Installation

ALB

Më brengën dhe shqetësimin, pikëlimin dhe dhimbjen që kemi për të dashurit tanë ne shumë herë e gjejmë veten në ndonjë vend që nuk e dimë as vet se si arritëm deri aty, se çfarë po bëjmë aty, dhe se a po shërohem nga ajo që na përcjell tash e shumë vite. Mirëpo ja që, edhe pse gjithçka mbaroi para 20 vitesh, sërish dhimbja është e freskët, sërish gjendemi përballë luftës me veten tonë, duke e bindur veten se ka shpresë, që ata një ditë do të kthehen.

“DHOMA E TË PAGJETURIT” është vepër e cila sadopak do të na ngushëllojë dhe do të na bëjë të meditojmë, të mendojmë se ku janë të dashurit tanë ... Dhoma në brendi ka skulpturën e kapelës së UÇK-së, ka një krevat, dhe altoparlantët të cilët vazhdimisht thërrasin emrat e të pagjeturve. Dhoma lart është e hapur që të mundësojë shikim të palimituar drejt qiellit, elementit kryesor të meditimit, dhe kjo gjë do të sjell sadopak qetësi shpirtërore për secilin që do ta provojë këtë gjë. Në këtë dhomë mund të futet çdokush, mund ta bëjë meditimin e tij për çfarëdo lloj nevojë që ai/ajo ka, madje mund të ndalen edhe emrat e njerëzve të zhdukur. Pra, një dhomë meditimi me fytyrë nga qielli, i shtrirë duke medituar, duke u inspiruar, duke shuar dhimbjen sadopak do të na ndihmojë të gjejmë forcën dhe shpresën që ata nuk kanë humbur, ata do kthehen.

Very often, when filled with concern and anguish, sadness and pain we have for our beloved ones we find ourselves in a place we have no idea how we got there, what are we doing there, and if we are healing from what accompanies us for years. Even though everything ended 20 years ago, the pain is still fresh, we are still faced with the fight within us, convincing ourselves that there is still hope, that they will be back one day.

ENG

“THE ROOM OF THE UNFOUND” is an art piece which will console us at least for a little bit and will make us meditate, think about the whereabouts of our loved ones ... The room has the sculpture of UÇK/KLA hat inside of it, has a bed, and speakers which constantly call upon the names of the unfound. Above, the room is opened to allow the unlimited view towards the sky, the main element of meditation, and this will bring at least a little bit of spiritual peace for everyone who will try it. Anyone can enter this room, can have his own meditation for any need he/she has, even the names of the lost ones can be stopped. Thus, a meditation room with a view towards the sky, lying and meditating, being inspired and wiping away the pain will help us at least a little bit to find the force and hope that they are not lost, they will be back.







Blerta Hoçia

A i kujtohem unë vetes time? / Do I remember me?

ALB

Interesimi për turmat dhe fuqinë e tyre vendimmarrëse vjen si rrjedhojë e punës sime si fotografe gjatë fushatës së zgjedhjeve lokale të 2015 në Shqipëri.

Isha e befasuar duke parë akoma në kohën tonë, grupime kaq të mëdha njerëzish të entuziazmuar pas një slogani apo partie politike. Gjatë kohës që fotografoja këto tubime madhështore, pyetja që më ushtonte në kokë ishte; si është akoma e mundur të hipnotizohen turmat?

Gjithashtu arkivi i internetit rezonon me fotogra_ të mbetura në memorien tonë kolektive për evente si hapja e ambasadave dhe anijet e mbushura me njerëz apo lufta civile e '97 apo manifestimet e shumta të viteve të regjimit komunist. Kam veçuar disa portrete nga turmat e kohëve të ndryshme, prej kur ka _lluar të përdoret fotogra_a në Shqipëri. Do të thoja që këto turma i përkasin disa datave decisive ku, përmirë a përkeq është vendosur fati i shumicës. Këto portrete vijnë që nga turmat e Lëvizjes Çlirimtare e deri te turmat e luftës civile të vitit 1997 duke vazhduar me turmat e mitingjeve partiake të ditëve të sotme. Këto portrete janë në një marrëdhënie komunikimi me njëri-tjetrin duke formuar një turmë të re si urgjencë për një fat të ri. A është e mundur që disa nga këto portrete të turmave të shkuara të jenë të njejtat me të sotmet dhe në këtë turmë të re ideale, të komunikojnë me veten duke i kërkuar të mos harrojnë.

*Portretet me dimensione të vogla janë marrë nga fotogra_t e gjetura në internet, nga arkivi i muzeut Marubi dhe nga arkivi im personal.

The interest in crowds and their decision-making power comes as a result of my work as a photographer during the campaign of local elections in Albania in 2015. I was surprised to see , even in our time, such large groups of people enthusiastic about a slogan or a political party. During the time I was photographing these magnificent gatherings, the question that kept emerging in my head was: how is it still possible to hypnotize crowds? The internet archives reason with photographs remained in our collective memory in events such as embassy openings and boats full of people, or the '97 civil war, or the numerous manifestations of the communist regime years. I have selected some portraits from crowds of different times, back from when photography started being used in Albania. These crowds belong to some decisive dates, on which, for good or bad, the fate of the majority was decided. The portraits come from the crowds from the Liberation Movement to the civil war crowds of '97, continuing to the party events of today. The portraits are in a communication relationship with each other, thus forming a new crowd as an urgency for a new destiny. Is it possible that some of the portraits of former crowds are the same with those of today and in this new ideal crowd, they communicate with themselves with a request not to forget?

*Small size portraits are taken from the internet, the archive of Marubi Museum and my personal archive.









Dardan Sopa

Rutinë / Routine, 2018

Derë në kornizë të drurit dhe tulla të betonit
Wooden door with frame and concrete bricks

ALB

Krejt çka mbaj në mend deri sot, e që në mendjen time bën presion është kërkesa për të dal jashtë. Në shkollë më thonin dil jashtë, sa herë që ndërhyja ose protestoja. Në shtëpi më thonin dil jashtë, sa herë që ndodhte diçka që nuk më takonte të dija.

Dil jashtë!

Kjo klithmë që në imagjinatën time mori një pjesë të madhe. Përcjellë shumë kujtime të cilat u ndërprejnë në gjysëm.

Kjo kërkesë më bëri të mendoj se a dalim jashtë më të vërtet, nëse po, ku dalim?

Një iluzion i hapësirës me kufij më bëri të kuptoj që koha dhe hapësira janë thjeshtë përceptime. Nëse ne dalim jashtë dhomës nënkupton që jemi në koridor, nëse ne dalim jashtë shtëpis jemi në kornizat e oborrit, nëse dalim jashtë oborrit jemi në kornizat e lagjës, etj.

“Kornizë e thjeshtë”, ndanë mendjen tonë me realitetin e kornizuar nga kornizuesit mendor.

ENG

Everything I remember until today, which puts pressure in my mind, is my will to get out. At school, they told me to go out, whenever I intervened or protested. At home they told me to go out, whenever something was happening that they didn't want me to know.

Get out!

This cry that in my imagination took a great deal. Conducted a lot of memories that broke in half.

This request made me think if we go out for real, if so, where do we go?

An illusion of a space with boundaries made me realize that time and space are just perceptions. If we go out of the room means we are in the corridor, if we go out of the house we are in the yard, if we go outside the yard we are in the neighborhood, etc.

"The Simple Frame" shared our minds with the reality framed by the mental framers.







Driton Selmani

Këto Tregime / These Stories

Video dy kanalësh / Two Channel Video, 7:3 min

ALB

Këto Tregime është një ëndërr e qartë e cila reflekton mbi kompleksitetet dhe kundërthëniet e realitetit, atmosferës dhe vendit, humbjes dhe shpresës. Vepra është një sajuese e mendjes dhe kujtesës. Ajo përdor gjuhë treguese për ta ballafaquar simbiozën e mistershme¹ të ngjarjeve, dyfishimin e kujtesës dhe prezencës, një ftesë për të parë në mes rreshtash të asaj që është para nesh dhe asaj që mund të jetë aty.

Këto Tregime kombinojnë video regjistrime të misionit origjinal Apollo 11, dhe audio tregim nga Sadik Cena b.1956, një anëtar i familjes sime. Tregimi i tij ndërlidhet me periudhën e njejtë të Misionit të NASA-s në Hënë. Në atë kohë ndodhi një ndryshim radikal në jetët e familjeve në Kosovë, duke përfshirë edhe familjen time. Në të njëjtën kohë Neil A. Armstrong shkeli në sipërfaqen e hënës, rrjeti elektrik arriti në fshatin tonë, e që në këtë mënyrë ne përfituam shumë vonë nga procesi i elektrizimit të programit për zhvillim ekonomik të ish Jugosllavisë. Vepra e vë në pyetje rëndësinë e këtyre dy ngjarjeve të ndara, duke e shkrirë Kujtesën në një Histori të vetme. Përderisa videoja tregon ndoshta arritjen më të madhe të njerëzimit, audio zëri reflekton mbi ndikimin paralel të diçkaje që është po aq e rëndësishme sa edhe e para, duke filluar nga tregimi shumë personal. Në këtë mënyrë e vë në dyshim jo vetëm misionin e NASA-s, por edhe rëndësinë e tij.

1. Frojdi e definon të mistershmen si një sferë të estetikës e cila nuk ka të bëjë me teorinë e të bukurës, por me teorinë e ndjenjës - në veçanti, të ndjenjës së neverisë dhe jorehatisë. Frojdi shkruan "se misteriozja është ajo klasë e tmerrit që çon pas te diçka që

“These Stories” is a lucid dream that reflects upon the complexities and contradictions of reality, atmosphere and place, loss and hope. The work is a mind and memory puzzle. It uses the narrative language to juxtapose an uncanny¹ symbiosis of events, a doubling of memory and presence, an invitation to see between the lines of what is in front of us and what might be there.

“These Stories”, combines the original Apollo 11 mission video footage, and the audio narration of Sadik Cena b.1956, a family member of mine. His story relates to the same period of NASA’s Lunar Mission. A radical change occurred in the lives of many families around Kosovo, including mine. At the same time Neil A. Armstrong stepped on the surface of the Moon, electricity network reached our village, thus benefiting very late from the electrization process during the ex Yugoslav economic development program. The work questions the importance of these two separate events, by merging the Memory into a single History. While the video shows perhaps the highest achievement of humanity, the audio voice reflects on the parallel impact of something just as important as the first one, starting from the very personal story. Doubting not only Nasa’s mission, but also its importance.

1. Freud defines the uncanny as a realm of aesthetics that pertains not to a theory of beauty, but rather a theory of feeling – in particular, to the feeling of repulsion and distress. “The uncanny”, Freud writes, “is that class of terrifying that leads back to something that is once hidden, but that subsequently, and disturbingly, comes to light.” Source: The Essential - René Magritte by Todd Allen.



Driton Selmani







Eliza Hoxha

HI-story of '90s

Plisi informativ / Informative hat
Instalacion / Installation, 2018

ALB

Përshëndetje për rrëfimet e të '90-tave, shumica prej të cilave informale dhe të pa treguara deri më tani. Të '90-tat për Shqipëtarët në Kosovë janë të njohura si periudha e paralelizmit, periferisë, mobilizimit shoqëror dhe aktivizmit si mënyrë mbijetese dhe jete jashtë sferës publike.

Nëse baza e fjalës histori është fjala “STORY” atëherë një pyetje bazike që na vjen përpara është se nga erdhi kjo “HI”. Kjo lojë apo ndarje e fjalës do të shfrytëzohet për ti treguar rrëfimet e pathëna dhe për ti përshëndetur ato sot për rëndësinë që e kanë mu sikur rrëfimet e mëdha të krijuara dhe të shkruara nga ata në pushtet. Paramendojeni se sa e sa rrëfime kanë mbet prapa apo përjashta rrëfimit të madh. Peizazhi i qytetit të viteve të '90-ta është karakterizuar nga satelitët e varur nëpër ballkonet e shtëpive të shqipëtarëve, që mundësoj hapësirë për ushqimin e shpirtit tonë. Sateliti u bë koka jonë, streha apo / edhe pjata ushqyese për të gjithë ne. Ky instalacion këtu i përmbledhur në formën e një kupolle apo më mirë të themi një kapele ashtu si është PLISI për shqipëtarët. Në kohën kur nik kishin casje tek kupolat e bibliotekës si kupola të iluminimit, kohë kjo kur një tjetër kupolë religjioze u vendosë me forcë nga regjimi i atëhershëm – kjo kupolë satelitësh si PLIS INFORMATIV do tu kundërvihet si një pasqyrë e thyer se çfarë ishin të '90-tat dhe çfarë kanë prodhuar ato në kuptimin hapësinor dhe shoqëror. Sateliti si një element gjenerik-global bëri të mundur mirëmbajtjen dhe ushquë identitetin kombëtar – e PLISI është elementi për tu shenjuar dhe njohur.

Say HI to stories of '90s in Kosovo, most of them informal and untold until now. '90s for Albanians in Kosovo are known as a period of parallelism, periphery, social mobilization and activism as a way of surviving and living out of public sphere.

ENG

If a basis of a word History is a word "STORY", then one basic question is where does this "HI" came from? This interplay and/or division of the word itself will be used to tell stories untold and to salute them today as being as much as important as the official HIGH-story created and written from those in power. Imagine how many other stories were left behind and/or outside. The city scape of '90s was characterized by satellites hanged in the balconies of every Albanian house, which made possible a space for feeding our souls. The satellite became our head, shed and/or feeding dish for all of us. This installation here gathered in a form of a dome or maybe better to say in a form of a hat as PLISI is for Albanians. In the time where we couldn't approach the library domes as illumination dome, a time when another religious dome was placed by force from the regime of that time at the university center – this satellite dome of INFORMATION PLIS will juxtapose what the broken mirror of the '90s was and what did it produced spatially and socially. Satellite as a generic – global element made possible to maintain and feed our national identity and PLISI is the element to recognize and highlight.









Jetullah Sylejmani

Socekspresionizmi / Socexpresionism, 2017

Instalacion / Installation, 2 x 200 x 160 cm

Postproduksion dixhital me pjesë të ndryshme të pikturave socrealiste, të kompozuar si vepra të artit modern, me anë kompjuterit. /

Digital postproduction with various portions of socrealist paintings, composed as works of the modern art, by using the computer.

UV printed në pëlhurë / UV printed on the canvas

ALB


Siç edhe dihet socrealizmi ishte arti zyrtar i shteteve komuniste, që kishte konturuar artin mbrenda kornizave ideologjike, duke propaganduar dhe shtrembëruar të vërtetën dhe duke u mohuar artistëve mundësinë që të pasqyronin realitetin përmes veprave të tyre.


Andaj kjo vepër e titulluar në formë kontradiktore e ironike “Socekspresionizmi” si drejtim artistik i panatyrshëm dhe jo ekgzistues, është një kollazh me pjesë nga pikturat e socrealizmit shqiptar, në formën e postproduksionit, përmes së cilës ndërhy “dhunshëm” në histori përmes një intervenimi artistik dhe “kirurgjik” duke nxjerrë nga ajo atë që nuk e kishte, për ta parë dhe zhvendosur atë në kontekste të ndryshme.

As is known, socrealism was the official art of communist states that had contoured art within ideological frames, by propagating and deforming the truth and by negating to the artists the opportunity to reflect the reality through their works of art.

Therefore this work titled contradictory and ironically “Socexpresionism” as an unnatural and inexistent artistic movement, is a collage with parts from the Albanian socrealism paintings, in the form of postproduction, through which I intervene “violently” in history through an artistic and “chirurgical” intervention and bringing out from it what it didn’t have, in order to see and displace it into different contexts.

ENG





Matilda Odobashi

Përtej perdeve / Beyond the curtains, 2018

Cikli i 19 Fotografive Digjitale /

Cycle of 19 Digital Photographs

15 x 20 cm

ALB

“Popullsia e Melania-s ripërtërihet vetë: pjesëmarrësit në dialog vdesin një nga një dhe në ndërkohë ata të cilët vijnë në vend të tyre lindin, disa në njërën rol e disa në tjetrin. Kur ndonjëri e lë rolin apo largohet përgjithmonë nga katrori apo hyn për herë të parë në të ndodh një seri e ndryshimeve deri sa të gjitha rolet janë rindarë; por në ndërkohë plaku i hidhëruar vazhdon duke i kthyer përgjigje shërbëtores mendjemprehtë, fajdexhiu asnjëherë nuk ndalet së përcjelluri rininë e lënë, motra medicinale e ngushëllon thjeshtren, edhe nëse asnjëri nga ta nuk i mbajnë sytë dhe zërin e njëjtë si në skenën paraprake”.

Kujtesa Kolektive bazohet në një sistem të shenjave, simboleve dhe praktikave. Kështu që historia dhe kujtesa ndajnë të njëjtat pika të ngjashmërisë; njëra nga këto është ‘kthesa hapësinore’ - ‘aty ku idetë për hapësirën dhe vendin kodohen me identitetin (et), kujtesën dhe historitë individuale dhe kolektive’. Në këtë pikë, personalja dhe kolektivja shkrihen, ashtu që “thjesht aroma e gatimit zgjon një civilizim të tërë” Por historia nuk është as kujdestare as ndërtuese e kabinetit. Ajo është përpjekje drejt të kuptuarit më të mirë. Vepra ime është hulumtim i vazhdueshëm drejt të kuptuarit të historisë së qytetit, materialit të tij dhe gamës së kujtesës përtej perdeve të materialit të tij. Qëllimi im është ta dekoj hapësirën dhe vendet e banuara nga këta njerëz të cilët përmes lenteve të nostalgjisë e rishkruajnë historinë e qytetit të tyre për shkak se nostalgjikja gjithnjë “kërkon adresë shpirtërore”. E ballafaquar me heshtje, ai kërkon shenja kujtese, duke i lexuar gabimisht”. Këto seri të fotografive të cilat i kam bërë në hapësira publike dhe private nëpër qytet dhe të cilat i kam ndryshuar me qëllim tregojnë leximin e gabuar të historisë së përbashkët përmes lenteve të kujtesës personale.


“Melania’s population renews itself: the participants in the dialogues die one by one and meanwhile those who will take their places are born, some in one role, some in another. When one changes role or abandons the square forever or makes his first entrance into it, there is a series of changes, until all the roles have been reassigned; but meanwhile the angry old man goes on replying to the witty maidservant, the usurer never ceases following the disinherited youth, the nurse consoles the stepdaughter, even if none of them keeps the same eyes and voice he had in the previous scene”.

Collective memory is based on a system of signs, symbols and practices. Thus history and memory share points of similarity; one of those being the ‘spatial turn’ – ‘where ideas about space and place are encoded with individual and collective identity (ies), memories and histories’. At this point, personal and collective merge, so that “the mere smell of cooking can evoke a whole civilization” But history is neither watchmaking nor cabinet construction. It is an endeavour toward better understanding. My work is a continuous research towards the understanding of the city’s history, its fabric and the multitude of memories beyond the curtains of its fabric. My aim is to decode the spaces and places inhabited by these people whom through the lenses of nostalgia rewrite the history of their city because the nostalgic is always “looking for a spiritual addressee. Encountering silence, he looks for memorable signs, desperately misreading them”. The series of photos I have taken in public and private spaces through the city and which I have purposely altered show these misreading of the common history through the lenses of personal memory.









Orhan Kurtolli

Një histori e shkurtër për nënën, 2018

Një histori e shkurtër për nënën / A short story about my mother, 2018, 50 x 40 cm,
Akrilik në pëlhurë / Acrylic on canvas

ALB

E kaluara përgjatë historisë së njerëzimit është regjistruar e regjistrohet në mënyra të ndryshme, dhe padyshim se kujtesa, fillimisht si funksion biologjik, e mundëson edhe realizimin e llojllojshëm të regjistrimeve. Historia është e njohur si disiplinë e regjistrimit dhe interpretimit të kujtesës mbi të kaluarën. Por, e kaluara, si kujtesë dhe histori në të gjitha nuancat e mundshme, është materializuar e shprehur në krijimtarinë artistike në poaq nuanca të shumta si: shkrim, skulpturë, pikturë e performance tjera.

Në studimet mbi kujtesën janë aktuale debatet mbi llojet e kujtesës dhe mënyrat e përkujtimit apo mbamendjes. “A mund të ketë fare kujtesë kolektive?”, kishte pyetur Bartlett në vitin 1932 derisa Schudson 1992, përkundrazi, kishte pyetur “A mund të jetë kujtesa tjetërsoj pos kolektive?”, dhe si përgjigje Wertsch dhe Roediger kishin dhënë një pikëtakim të këtyre dy pozicioneve, se “duhet pajtuar që individët e situuar shoqërisht janë agjentë të mbamendjes”.

Këta agjentë të mbamendjes dhe materializimit të saj si përkujtim janë pra artistët që përmes kujtesës individuale, shprehjes estetike personale, flasin për të kaluarën e cila është pjesë e një historie kolektive, e një kulture. Ata janë zëri, janë rapsodët e ngjarjeve dhe përjetimeve të caktuara në një kohë e vend të caktuar.

Në punimin në fjalë mund të shihet një rrëfim dhe ndërlihdje e tillë. Gruaja me mbulesë është pjesë e kujtesës sime individuale nga fëmijëria. Është gruaja e mbuluar me perçe, me vellë të zezë, e cila lehtë simbolizon edhe kujtesën që me kohë mbulohet me perçen e harresës. Por, në këtë rast kujton një pamje të rëndomtë nga e kaluara, pra është histori. Në rrugët tona gratë hecnin të veshura njësoj, dhe ishte kjo veshje pjesë e një realiteti kulturor të qytetit tonë. Ishte pjesë e një statusi shoqëror të grave tona.

Nanat e tezet mund të na ngatërroheshin lehtë kur i

vërenim derisa luanim në rrugët e lagjes. Nga ecja e lehtë a mënyra e mbajtjes së duarve edhe mund të dinim është nëna Hilmije apo tezja Sadije, por megjithatë, kishim hamendje. Dhe nëse mendonim të vraponim në përqafim të tyre duhej vlerësuar e rivlerësuar forcën e përqafimit. Tezja duhej përqafuar më fortë se e takonim më rrallë! Jo vetëm ne fëmijët, po edhe burrat, baba apo burri i tezes, që rrinin së bashku në ‘sokak’, ulur pranë një guri të ndonjë dere oborri, që pinin duhan dhe bisedonin për hallet e ditës, kishin një dozë hamendjeje. Ndonjëherë hamendja mund të kthehej edhe në lojë a garë mes tyre. “Jo, kjo është Hilmija” mund të thoshte njëri, “jo, jo është Sadija” vazhdonte tjetri.

Sot çdo herë e më shpesh mund të shohim pamje të tilla të grave. Dhe kjo e sotme na bën të mendojmë, nëse duhet parë në të ardhmen më kthjellët apo duhet insistuar në qartësimin e pamjeve!?

Kjo pikturë si rezultat i kujtesës individuale, është përkujtim në një të kaluar kolektive, e cila sot mundet të kuptohet qartazi si përkujtues i zgjedhjeve që mund a duhet të bëjnë brezat sot dhe në të ardhmen. Kjo pikturë mund të kuptohet si mesazh se kujtesën duhet shpalosur nga mjegulla e harresës dhe gratë sot duhet qartësuar jo vetëm pamjet por edhe vizionin e tyre. Kjo pikturë mund të simbolizojë një rezistencë ndaj një të kaluar sa nostalgjike po aq edhe të padëshiruar jo vetëm për gratë, por për shoqërinë në përgjithësi. Konceptet abstrakte si të drejtat e njeriut janë shpesh të paqarta por përkujtimet dhe arti janë përcues kuptimesh dhe mund të qartësojnë disa dimensione dhe versione të këtyre të drejtave.

Zgjedhjet e mundësitë gjithherë janë të shumta dhe përkujtimet, sidomos ato vizuale, lehtësojnë të shihet më qartë një e ardhme e synuar.

ENG

The past throughout the history of mankind has been recorded and recorded in various ways and no doubt that memory, initially as a biological function, also enables the realization of a variety of recordings. History is known as the discipline of recording and interpretation of memory over the past. But past, as memory and history in all possible nuances, is materialized and expressed in artistic creativity in the same many nuances as writing, sculpture, painting and other performance.

In memory studies, there are current debates on memory types and remembrances or overwhelming. Can there be any collective remembrance Bartlett asked in 1932 while Schudson 1992, on the contrary, had asked Can memory be alienated except collective, and in response, Wertsch and Roediger had given a point to these two positions, that it should be agreed that socially-owned individuals are agents of the detention. These agents of the preservation and materialization of it as commemoration are therefore artists that Through individual memory, aesthetic personal expression, talk about the past which is part of one collective history, of a culture. They are voices, are the rhapsodies of events and experiences certain at a certain time and place. Art and artists are a beautiful crossroad bridge between the past, the present, and the future. Works there are aesthetic of feelings, experiences, meanings, and meanings through generations. There is the most open possibility for experiencing and acting as individual as the creator and the public, both the individual and the collective. This story can be seen in such a story. The woman with a bonnet is part of my individual memory from childhood. It is the woman covered with spikes, with her veil black, which easily symbolizes the memory that is covered by the obsession with forgetfulness. But in this case reminiscent of a common view of the past, that is history. In our streets women hennin dressed alike, and this dress was part of the

cultural reality of our city. it Was part of the social status of our women. The rumors of the song could be easily confused when we watched them while we were playing in the streets of the neighborhood. From the easy walking and the way of holding hands we could even know is Hilmije or aunt Sadija, however, we had guesswork. And if we were thinking of running into their hug the hug strength should be revalued. My aunt should be embraced stronger than we met anymore rarely! Not only in the children, but also in the husbands, daughters, or the husband of the thesis, who were together in the sokak, sitting next to a stone of a yard door, smoking and talking about the daylight, they had a sort of guesswork. Sometimes conjecture could turn into a game or race between them. No, this its Hilmi, one could say, no, not Sadija, the other said.

Today, we can often see such images of women every now and then. And this today makes us we think, whether to look brighter in the future or to insist on clarifying sights !?

This painting as a result of individual memory is a commemoration of a collective past, which today can be clearly understood as a reminder of the choices that a generation may have to do today and on the future. This painting can be understood as a message that the memory should be unfurled by the Fog forgetfulness and women today need to clarify not only the views but also their vision. This painting can symbolize a resistance to a nostalgic as well as unwanted past not only for women but for society in general. The abstract concepts as human rights are often unclear but commemoration and art are conducive to the meaning and can clarify some dimensions and versions of these rights.

Choices and opportunities are always numerous and reminders, especially visual ones, facilitate to see clearly a target future.







Një histori e shkurtër për nënim

E kaluara përgjithësisht historikisht së njëlucimit është regjistruar e regjistruhet në mënyra të ndryshme, dhe përdyhim se kujtesa, fillimisht si funksion biologjik, e mundëson edhe realizimin e kujtesës në regjistrimeve. Historia është e njohur si disiplinë e regjistrimit dhe interpretimit të kujtesës mbi të kaluarën. Por, e kaluara, si kujtesë dhe histori në të gjitha nuanat e mundshme, është materializuar e shprehur në krijimet e artitike në poq nuanat të shumta si: shkrim, skulpturë, pikturë e performance tjera.

Në studimet mbi kujtesën janë aktualë debatet mbi lojet e kujtesës dhe mënyrat e përkujtimit apo mbamendjes.

"A mund të ketë fare kujtesë kolektive?", kishte pyetur Bartlett në vitin 1932 derisa Schudson 1992, përkundrazi, kishte pyetur "A mund të jetë kujtesa tjetërsoj pos kolektive?", dhe si përgjigje Wertsch dhe Roediger kishin dhënë një pikëtim të kështre dy pozicioneve, se "duhet pajtuar që individët e situatave shoqërisht janë agjentë të mbamendjes".

Këta agjentë të mbamendjes dhe materializimit të saj si përkujtim janë pra artistët që përmes kujtesës individuale, shprehjes estetike personale, flasin për të kaluarën e cila është pjesë e një historie kolektive, e një kulture. Ata janë zëri, janë repozitë e ngjarjeve dhe përjetimeve të kaluara në një kohë e vend të caktuar.

Në punimin në fjalë mund të shihet një rritim dhe ndërlidhje e tërë. Gruaja me mbulesë është pjesë e kujtesës si individuale nga familja. Është gruaja e mbuluar me perçe, me vetë të zezë, e cila lehtë simbolizon edhe kujtesën që me kohë mbulohet me perçen e harrës. Por, në këtë rast kujton një pamje të rëndomtë nga e kaluara, pra është histori. Në rrugët tona gratë hecin të veshura njësoj, dhe ishte kjo veshje pjesë e një realiteti kulturor të qytetit tonë. Ishte pjesë e një statusi shoqëror të grave tona.

Narat e testit mund të na ngatërroshin lehtë kur i vënim derisa kuanim në rrugët e lagjes. Nga eja e lehtë a mënyra e mbajtjes së duarve edhe mund të dinim është nëna Hilmiye apo teja Sedja, por magjithatë, kishim hamendje.

Dhe nëse mendonim të vraponim në përfaqsim të tyre duhej vlerësuar e rrvlerësuar forcën e përfaqsimit. Teja duhej përfatuar më fort se e takonim më rrallë! Jo vetëm në filmjet, po edhe burrat, baba apo burri i tezes, që mirin së bashku në "sokak", ur pranë një gurit të ndonjë dore oborri, që pinin duhan dhe bisedonin për hallet e ditës, kishin një dozë hamendjeje. Ndërkohësi hamendja mund të kthehej edhe në lojë e garë me tyre. "Jo, kjo është Hilmiye" mund të thoshte njëri, "jo, jo, është Sedja" vazhonte tjetri.

Sot çdo herë e më shpesh mund të shohim pamje të tilla të grave.

Dhe kjo e sotme na bën të mendojmë, nëse duhet parë në të ardhmen më kthjellët apo duhet insistuar në qartësimin e pamjeve?

Kjo pikturë si rezultat i kujtesës individuale, është përkujtim në një të kaluar kolektive, e cila sot mundet të kuptohet qartazi si përkujtesa i zgjedhjeve që mund a duhet të bëjnë brazat sot dhe në të ardhmen. Kjo pikturë mund të kuptohet si mesazh se kujtesën duhet shpaltosur nga rrjegulla e harrës dhe gratë sot duhet qartësuar jo vetëm pamjet por edhe vizionin e tyre. Kjo pikturë mund të simbolizojë një rezistencë ndaj një të kaluarë se nostalgjike po atë edhe të paddëshinuar jo vetëm për gratë, por për shoqërinë në përgjithësi. Konceptet abstrakte si të drejtat e njeriut janë shpesh të paqarta por përkujtimet dhe arti janë përqes kujtimeve dhe mund të qartësojnë disa dimensione dhe versione të kështre të drejtave.

Zgjedhjet emundisito gjithënjë janë të shumta dhe përkujtimet, sidomos ato vizuale, lehtësojnë të shihet më qartë një e ardhme e synuar.

Orhan Kurtoll

16 Gusht 2018
Pristinë

Remijon Pronja

Dikush bëri një zgjedhje / Someone made a choice,
2016 – 2018

Instalacion, fustane, yndyrë, plastikë & materiale të përziera /

Installation, dresses, grease, plastic & mix materials

Vizatime, letër, laps, ngjyra uji

Drawings, paper, pen, watercolour

30 x 40 cm

ALB

Instalacioni përbëhet prej disa thasëve në formë skulpture së bashku me një seri të vizatimeve. Përderisa thasët janë replikë e qeseve të trasha të plastikës të mbushura me gjëra për mbijetesë, të cilat u përdorën nga emigrantët që iknin nga Shqipëria në vitet e 1970-ta dhe 80-ta, vizatimet paraqesin një aspekt tjetër të vijës bregdetare prej nga të arratisurit iknin. Instalacioni i rikujton plazhet përgjatë Detit Adriatik, të cilat ishin vend edhe për ikjet e njerëzve edhe për pushimet e tyre verore. Nga të dyja perspektivat, kjo vijë e gjatë e tokës përfaqësonte një dërrasën kërcyese për një të ardhme më të mirë në horizont në kohën e diktaturës komuniste. Në atë kohë, shumë shqiptarë u përpoqën të largohen nga vendi i tyre në mënyrë sekrete, duke notuar, ku gjasat ishin më të mëdha të fundosen apo edhe të kapen nga qeveria më parë. Pavarësisht nëse kishin sukses ose jo në përpjekjet e tyre të rrezikshme, çdokush nga familja e tyre apo kushdo që ishte i lidhur me dezertorët dënohej shumë rëndë. Çmimi i lirisë së njeriut ishte shumë i lartë deri sa i shtyri shumë shqiptarë të nisen në udhëtimet e tyre të gjata. Përgjatë thasëve, një seri prej gjashtë vizatimesh e plotëson pjesën tjetër të medaljes. I inspiruar nga fotografitë e vjetra të arkivit, këto ambiente natyrore janë sjellë në jetë duke përdorur piktura me ngjyra uji dhe pendë, e që duken si foto çasti dhe kartolina pezull të asaj kohe.

The installation consists of several sculpture-like sacks along with a series of drawings. While the sacks are a replica of a fat-covered plastic bag filled with self-survival belongings, which were used by migrants escaping Albania in the 1970s and 80s, the drawings represent another aspect of the coastline from which fugitives would run away. The installation recalls the beaches along the Adriatic Sea, which were the settings of both, people's getaways and their summer holidays. From either perspective, this long stretch of land used to represent a springboard to a better future over the horizon at the time of the communist dictatorship. Back then, many Albanians attempted to escape their country in secret, by swimming, being more likely to drown or even be caught by the government beforehand. Regardless of whether they were successful or not in their risky venture, anyone from their family or who was linked to the deserters would be punished harshly. The price of human freedom was high to the extent it would push lots of Albanians to set out on their long journeys. Alongside the sacks, the series of six drawings complete the other side of the same coin. Inspired by old archival photos, those natural settings are brought to life using watercolor painting and ink-pen, appearing as suspended snapshots and postcards of that time.

ENG









Roland Masurica

Memoria / Memory

Instalacion, skulpturë / Installation, sculpture

ALB

Historia është një shkencë që merret me studimin e të kaluarës sonë por edhe të tashmes.

Kështuqë natyrisht se kujtimet tona përbëjnë historinë e të kaluarës tonë dhe e vetmja që na mbetet në kujtesë është e kaluara te cilën jemi të prirë që t'ia rrëfejme të tjerëve.

Me këtë punim unë kam zgjedhë që të rrefej të kaluarën e fëmijërisë sime e cila për mua shënon historinë e jetës.

History is a science that deals with studying our past but also to the present.

ENG

Therefore, naturally our memories are the contents of our past's history and the only thing that remains in our memory is the past that we tend to tell the others about.

This work is the way I chose to tell the past of my childhood that marked my life's history.







Rozafa Imami

Historia e redaktuar / Redacted History, 2018

inkjet print, black marker, scan

ALB

Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe dhe fjalori Merriam-Webster e definojnë redaktimin kështu: “Ndreqja dhe përpunimi i një shkrimi apo vepre për t’i dhënë trajtën përfundimtare përpara se të botohet” dhe “Selektimi apo adaptimi i informatave speci_ke për publikim (duke i errësuar ose duke larguar pjesët e ndjeshme)”. Vepra i drejtohet dukurisë së legjitimitetit të historisë selektive – asaj të redaktuar, që rrjedh nga vështirësia e procesimit të shëndetshëm të pjesëve të ndjeshme të historisë së një populli. A mundet ndryshimi i historisë zyrtare të ndryshojë edhe kujtesën e popullit, dhe nëse mundet, çka do të thotë kjo për ndryshesin e historisë dhe për të ardhmen e atij populli?

The Albanian language dictionary and Merriam-Webster dictionary define redacting as follows: "Fixing or editing a script or work to prepare the final version before publishing" and "Selecting and adapting specific information for publishing (by obscuring or removing sensitive parts). The work is about the phenomenon of the legitimization of selective history - the edited one - that comes from the difficulty of processing sensitive parts of history in a healthy way. Can the change of official history change the collective history of the people as well, and if so, what does this mean for the changemaker of that history and for the future of those people?

ENG







Monumenti kushtuar heronjëve të Lëvizjes
Nacionale Çlirimtare
Vendi: Prishtinë, Kosovë
Autori: [redacted]
Viti: 1961

Monument to Heroes of the National
Liberation Movement
Location: Prishtina, Kosovo
Author: [redacted]
Year: 1961

Gjendet në qendër të qytetit të Prishtinës, mes ndërtesës së Kuvendit të Kosovës dhe asaj të Komunës së Prishtinës, në sheshin e quajtur "Adem Jashari". Është ndërtuar në vitin 1961 nga skulptori [redacted]. Zyrtarisht njihet si monument i kushtuar heronjëve të Luftës Nacional-Çlirimtare, që u kryengritën kundër okupimit fashist gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ai ka për qëllim të simbolizojë [redacted] dhe [redacted] midis shqiptarëve, [redacted] dhe nacionaliteteve tjera dhe për këtë shpesh quhet "Përmendorja e [redacted]". Monumenti përbëhet nga tre pjesë: një obelisk 22 metresh me tre shtylla dhe një skulpturë që përfaqëson tetë [redacted] të vendosur dhjetë metra larg obeliskut. Ka pasur një tentim të dështuar për ta demoluar monumentin, kështu që më vonë figurat e [redacted] u ngjyrosën me ngjyrat e flamujve të shteteve që njohin pavarësinë e Kosovës.

It is located in the centre of Prishtina, between the building of the Assembly of Kosovo and the Municipality of Prishtina, on the square called "Adem Jashari". It was built in 1961 by the sculptor [redacted]. Officially, it is known as the monument dedicated to the heroes of the National Liberation War, who rebelled against the fascist occupation during World War II. It intends to symbolise [redacted] between Albanians, [redacted] and other nationalities which is the reason why it is also referred to as the "[redacted] Monument". The monument consists of two parts: a 22 metre tall obelisk with three poles and a sculpture portraying eight [redacted] figures placed ten metres in front of the obelisk. There was a failed attempt to demolish the monument, so later the sculptures of [redacted] were painted in the colors of the flags of the countries that recognize Kosovo independence.



Monumenti e Revolucionit

Vendi: Pejë, Kosovë

Skulptor: [REDACTED]

Arkitekt: [REDACTED]

Viti: 1972

Revolution Monument

Location: Peja, Kosovo

Sculptor: [REDACTED]

Architect: [REDACTED]

Year: 1972

Monumenti nga alumini dhe betoni gjendej në Parkun Karagaq të Pejës. U ndërtua në vitin 1972 nga skulptori [REDACTED] dhe nga arkitekti [REDACTED]. Monumenti i kushtohet [REDACTED] nga viti 1941-1945. Në rrathet e granitit gjendeshin emrat e [REDACTED]. Në vitin 2011 monumenti u demolua me dinamit dhe u shkatërrua.

The monument made of concrete and aluminum was placed in Peja Karagaq Park. It was built in 1972 by sculptor [REDACTED] and by architect [REDACTED]. The monument is dedicated to [REDACTED] during 1941-1945. On the granite belts of the monument, [REDACTED] were displayed. In 2011 the monument was demolished and destroyed with dynamite.

Vigan Nimani

Pikturë / Paintings

ALB

Pikturat e Vigan Nimanit bëjnë fjalë për socializmin. Më saktësisht, atmosfera në piktura pasqyron jetën socialiste të cilën ai e kujton nga fëmijëria dhe e rekonstrukton nga fotografitë. Duke shikuar këto fotografi, lehtësisht mund të ndjehet të qenit jashtë kohës dhe në hapësira pa lokacione të specifikuar. Prapë, ato janë shumë të njohura. Njerëzit lokal mund të njohin pjesët e ndonjë ndërtese famëkeqe, pamjeje, dhe me lehtësi mund të ndërlidhin këto ndërtesa me vitet e shtatëdhjeta dhe të tetëdhjeta, më shume se me ndonjë situatë bashkëkohore. Por sharmi vizual i pikturave prezenton tepriçën e analizave sociologjike. Atmosfera e pikturës thërret nga kujtesa marëdhënien e çuditshme me socializmin: diçka shumë e fuqishme dhe konkrete, si ndërtesat, që ende i pushtojnë kujtimet tona, që megjithatë kjo diçka egziston vetëm si kujtesë ëndërruese e të kaluarës.

...

Si rezultat, kemi piktura që nuk bëjnë kompromis me kuptimin mbizotërues të socializmit, por në vend të kësaj, e zhvillojnë idenë kryesore të pëerfaqësimit të së resë në socializëm, duke u fokusuar në aspektin teknik të vizualitetit të kësaj bote.

Paradoksalisht meqë prek çështje konkrete, kjo zgjidhje teknike pikturale është më e fuqishmja mu në fushën të cilën e mohon, sidomos në domenin e subjektivitetit të thellë dhe ëndrrës për utopi.

The paintings of Vigan Nimani are about socialism. Precisely, the atmosphere of the paintings are a socialist life that he remembers from the childhood and reconstructs from the photographs. Looking at these paintings, one can easily grasp the sense of being outside of time and in spaces that do not have specific locations. Yet they are very familiar. The locals can recognize the traces of some notorious socialist buildings, sights, and also they would easily connect these paintings with the seventies or the eighties, rather than to contemporary situation. But the visual charm of the paintings introduces the excess to usual sociological analyses. The atmosphere of the painting is recalling strange sort of relationship to the socialism: something as very strong and concrete, as buildings, that still pervade our memories, but still that something exists only as a dreamy recollection of the past.

...

As a result, we have paintings that do not compromise with mainstream understanding of the socialism but instead they develop the main idea of the representation of the new in socialism by focusing on the technical aspect of the visuality of that world.

Paradoxically, because it is touching upon the concrete issues, this technical and painterly solution is strongest in the field which it is negating, namely in the domain of profound subjectivity and dream for utopia.

Sezgin Boynik

Janar/January 2018 Helsinki









Valdrin Thaqi

Rikujtimi i Kujtimeve / Recalling Memories, 2018

Dhomë / Room , 404 x 445 cm

Tepih, Audio / Carpet , Audio

ALB

Kujtesa është një gjë shumë e brishtë. Ajo është konstruktive, ajo është rikonstruktive. Mund të hysh e të dalësh, mund ta ndryshosh. Të gjithë ne vuajmë nga kujtesa e shtypur, dhe kjo nuk na sfidon ne sepse ne brengosemi me ato kujtime vetëm kur fillojmë t'i rikujtojmë kujtimet që na e sfidojnë realitetin momental.

Fitues / Winner of Muslim Mulliqi 2018

Memory is a very fragile thing. It is constructive, it is reconstructive. You can go in and out, you can change it. We all suffer from repressed memory, and this doesn't challenge us because we only become concerned with those memories when we start to recall memory that challenges our current reality.

ENG



Valdrin Thaqi



